

Analizë e Votimit nga Diaspora ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Shkurt
Dhjetor 2025





Analizë e Votimit nga Diaspora

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Shkurt Dhjetor **2025**

Ky publikim është përkrahur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Deklaratë: Pikëpamjet dhe analiza në këtë publikim janë tërësisht të GERMIN dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

GERMIN
MAJ 2025

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive.....	3
Hyrje.....	4
Metodologjia dhe burimet e të dhënave.....	5
Konteksti ligjor dhe reforma e Votimit Jashtë Kosovës.....	6
Zgjedhjet 2025: Regjistrimi dhe Votimi nga Jashte Kosovës.....	7
Organizimi i votimit në misione diplomatike në zgjedhjet e vitit 2025.....	11
Pjesëmarrja dhe mënyrat e votimit në vitin 2025.....	13
Efikasiteti i procesit.....	14
Ndikimi elektoral i votës së diasporës.....	15
Kandidatët më të votuar.....	17
Sfidat kryesore në organizim, qasje dhe transparencë.....	18
Rekomandimet.....	20
Përfundime.....	22

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2025 shënoi fazën më të rëndësishme të transformimit të Votimit Jashtë Kosovës që nga krijimi i këtij mekanizmi. Për herë të parë, qytetarët jashtë vendit nuk u kufizuan vetëm në votimin me postë, por patën mundësi të votojnë edhe fizikisht në përfaqësi diplomatike dhe të përdorin kuti postare jashtë Kosovës. Megjithatë, përvoja e dy proceseve zgjedhore të vitit 2025 tregoi se zgjerimi i mundësive ligjore nuk mjafton pa planifikim të hershëm, informim të qartë, kapacitete operacionale dhe standarde të unifikuara.


Kosova ka bërë progres të rëndësishëm në qasjen e diasporës në procesin zgjedhor, sidomos pas ndryshimeve ligjore të vitit 2023, të cilat për herë të parë mundësuan votimin fizik në përfaqësitë diplomatike dhe dërgimin e fletëvotimeve në kuti postare jashtë Kosovës.

Ky raport analizon organizimin, pjesëmarrjen dhe rezultatet e Votimit Jashtë Kosovës në dy ciklet parlamentare të vitit 2025: zgjedhjet e rregullta të shkurtit dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të dhjetorit. Përmes krahasimit me ciklet e mëparshme zgjedhore, raporti shqyrton zhvillimet kryesore në regjistrimin e votuesve, mënyrat e votimit, pjesëmarrjen e diasporës, rezultatet sipas subjekteve politike dhe kandidatëve, si dhe sfidat procedurale të evidentuara gjatë procesit.

Pavarësisht mundësive të reja, votimi përmes postës mbeti forma dominuese e pjesëmarrjes së diasporës. Në shkurt 2025, nga 79,019 vota të pranuar nga diaspora, 63,667 erdhën përmes postës dhe 15,352 nga përfaqësitë diplomatike. Në dhjetor 2025, 46,565 vota të ardhura përmes postës u konsideruan për numërim, ndërsa 16,165 votues morën pjesë fizikisht në përfaqësitë diplomatike. Nga votat e numëruara, 62,194 u pranuan si të vlefshme. Kjo tregon se votimi fizik nuk e zëvendësoi votimin me postë, por krijoi një kanal shtesë të rëndësishëm, sidomos në vendet me diasporë më të përqendruar.

Në përgjithësi, raporti vlerëson se Kosova ka bërë progres real në zgjerimin e pjesëmarrjes së diasporës në zgjedhje, por sistemi ende ka nevojë për konsolidim. Për të qenë më i qëndrueshëm, transparent dhe i parashikueshëm, Votimi Jashtë Kosovës kërkon informim më të mirë publik, kritere më të qarta për hapjen e qendrave të votimit, standardizim të procedurave dhe planifikim më efikas operacional, sidomos në rastet e zgjedhjeve të parakohshme.

“ VITI 2025 SHËNOI TRANSFORMIMIN MË TË MADH TË VOTIMIT JASHTË KOSOVËS, DUKE ZGJERUAR FORMAT E PJESËMARRJES SË DIASPORËS PËRMES VOTIMIT ME POSTË, NË PËRFAQËSI DIPLOMATIKE DHE NË KUTI POSTARE JASHTË VENDIT, POR NJËKOHËSISHT DUKE NXJERRË NË PAH NEVOJËN PËR PLANIFIKIM MË TË MIRË, STANDARDIZIM PROCEDURAL DHE KAPACITETE MË TË FORTA ORGANIZATIVE.



HYRJE

Pas 18 vitesh, Kosova zhvilloi zgjedhje të rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 9 shkurt 2025. Ndonëse mandati i legjislaturës parashihet të zgjasë katër vjet, paqëndrueshmëria politike në vend ka bërë që përgjatë kësaj periudhe të mbahen pesë palë zgjedhje të parakohshme radhazi. Mungesa e stabilitetit politik vazhdoi edhe gjatë vitit 2025, kur më 28 dhjetor u mbajtën sërish zgjedhje të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, duke e bërë këtë vit një rast të pazakontë me dy procese zgjedhore parlamentare brenda të njëjtit vit kalendarik. Votimi nga diaspora ka qenë vazhdimisht pjesë e rëndësishme e proceseve zgjedhore në Kosovë. Me ndryshimet ligjore të vitit 2023, qytetarëve jashtë vendit iu mundësuan forma të reja të pjesëmarrjes, përfshirë votimin fizik në përfaqësitë diplomatike dhe dërgimin e fletëvotimeve në kuti postare jashtë Kosovës. Këto ndryshime shënuan një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të qasjes së diasporës në votim.

Ndryshime të rëndësishme u aplikuan edhe në procesin e numërimit të votave brenda vendit. Votat e dërguara me postë dhe ato të grumbulluara nga përfaqësitë diplomatike u verifikuan në ndërtesën e KQZ-së për t'u dërguar më pas në QNR për numërim dhe certifikim.

Pavarësisht sfidave të evidentuara, interesi i diasporës për pjesëmarrje në proceset zgjedhore vazhdoi të mbetet i lartë. Numri i aplikimeve për votim nga diaspora ka shënuar rritje të vazhdueshme ndër vite, duke kaluar nga 5,015 aplikime në vitin 2010 në një rekord prej 130,168 aplikimesh në vitin 2021. Në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, KQZ pranoi 115,226 aplikime për votim jashtë vendit – një numër më i ulët krahasuar me vitin 2021, por me një përqindje më të lartë të aplikimeve të aprovuara. Ndërsa në zgjedhjet e 28 dhjetorit kishte një ulje të aplikimeve, marrë parasysh periudhën kohore ku shumë prej pjesëtarëve të diasporës votuan fizikisht në Kosovë. Megjithëse një pjesë e konsiderueshme e aplikimeve nga diaspora vazhdon të refuzohet ose anulohet për arsye të ndryshme, shpesh të lidhura me mungesën e informimit adekuat, procesi dëshmoi një trend pozitiv drejt rritjes së përfshirjes së diasporës në jetën politike dhe demokratike të Kosovës.

Në fund, raporti ofron rekomandime për institucionet përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e organizimit, transparencës dhe qasjes së diasporës në proceset e ardhshme zgjedhore.


“ VITI 2025 PËRBËNTE NJË MOMENT TË RËNDËSISHËM PËR DEMOKRACINË NË KOSOVË, ME DY PROCESA PARLAMENTARE BRENDË TË NJËJTIT VIT DHE ME ZGJERIMIN E FORMAVE TË VOTIMIT TË DIASPORËS, DUKE DËSHMUAR RITJEN E PËRFSHIRJES SË QYTETARËVE JASHTË VENDIT, POR EDHE NEVOJËN PËR ORGANIZIM MË EFIKAS, INFORMIM MË TË MIRË DHE FORCIM TË KAPACITETEVE ZGJEDHORE.

METODOLOGJIA DHE BURIMET E TË DHËNAVE

Germin ka analizuar votimin nga Diaspora ndër vite, ku kjo analizë krahasuese kryesisht fokusohet në dy ciklet e zgjedhjeve të vitit 2025, përkatësisht zgjedhjet e rregullta të 9 shkurtit dhe zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit. Analiza është mbështetur në të dhëna dhe dokumente zyrtare të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), duke përfshirë të dhënat preliminare të publikuara në faqen zyrtare si dhe në ndryshimet e rregullores. Gjithashtu, janë analizuar dispozitat relevante të Ligjit 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe Kushtetutën e Kosovës. Të dhënat janë marrë nga disa burime:

- të dhëna zyrtare të KQZ-së;
- të dhëna të përpunuara sipas formës së votimit;
- monitorimin e Germin-it në përfaqësi diplomatike dhe QNR;
- raportet paraprake të Germin-it;
- raportet vëzhguese si EU EDM dhe KDI/DnV;
- exit poll-et vetëm si tregues orientues, jo si të dhëna zyrtare.

Germin poashtu ka monitoruar drejtpërdrejt proceset zgjedhore të votimit nga diaspora si gjatë fazës së votimit fizik në përfaqësi diplomatike përmes vëzhguesve të angazhuar në diaspora ashtu edhe gjatë fazës së numërimit dhe shpalljes së rezultateve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Analiza është plotësuar edhe me shqyrtimin e raporteve ndërkombëtare relevante që kanë trajtuar votimin jashtë vendit.



KONTEKSTI LIGJOR DHE REFORMA E VOTIMIT JASHTË KOSOVËS

E drejta e shtetasve të Kosovës për të votuar nga jashtë vendit garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 45, i cili përcakton se çdo shtetas që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet me vendim gjyqësor. Kjo e drejtë garantohet gjithashtu edhe përmes Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton procedurat dhe kriteret për regjistrimin dhe votimin e qytetarëve që jetojnë jashtë Kosovës.



KORNIZA LIGJORE E VOTIMIT JASHTË KOSOVËS U REFORMUA PARA ZGJEDHJEVE TË VITIT 2025, DUKE ZGJERUAR PJESËMARRJEN E DIASPORËS, POR ZBATIMI TREGOI NEVOJËN PËR MË SHUMË QARTËSI LIGJORE, STANDARDIZIM PROCEDURAL DHE ORGANIZIM MË EFIKAS.

Korniza ligjore për votimin jashtë vendit pësoi ndryshime të rëndësishme me miratimin e Ligjit nr. 08/L-228¹ për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Nr. 17/2024² të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të cilat ndikuan drejtpërdrejt në organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025. Këto ndryshime zgjeruan mënyrat e votimit për diasporën dhe sollën procedura të reja për regjistrimin, administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit.

Ndryshimi më i rëndësishëm i sjellë nga legjislacioni i ri ishte mundësimi, për herë të parë, i votimit fizik në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, krahas votimit përmes postës. Përveç kësaj, KQZ hapi edhe kuti postare jashtë Kosovës, në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike, duke krijuar alternativa shtesë për dorëzimin e fletëvotimeve. Në këtë mënyrë, qytetarët nga diaspora mund të zgjedhin ndërmjet tri formave të votimit: votimit fizik në ambasada dhe konsullata, dërgimit të fletëvotimeve në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë dhe dërgimit të tyre në kutitë postare të hapura jashtë vendit.

Rregullorja Nr. 17/2024 standardizoi gjithashtu procedurat për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës. Aplikimi mund të realizohej përmes platformës elektronike të KQZ-së ose përmes postës, ndërsa për herë të parë u aplikua verifikimi i dyfishtë i identitetit për aplikimet elektronike. Poashtu, rregullorja përcaktoi procedura të detajuara për administrimin e votimit në përfaqësitë diplomatike, transportimin dhe ruajtjen e materialit zgjedhor, si dhe për verifikimin dhe numërimin e votave në Kosovë.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve në zgjedhjet e vitit 2025 tregoi se, ndonëse korniza e re ligjore zgjeroi mundësitë e votimit jashtë Kosovës, ajo nuk e qartësoi plotësisht vendndodhjen e mundshme të qendrave të votimit fizik. Kjo u bë veçanërisht e dukshme në zgjedhjet e dhjetorit 2025, kur vendimi fillestar për hapjen e qendrave shtesë jashtë hapësirave diplomatike u kontestua dhe më pas u anulua nga PZAP. Ky rast tregon nevojën që ligji të përcaktojë qartë nëse votimi fizik jashtë Kosovës mund të zhvillohet vetëm në objekte diplomatike apo edhe në hapësira të tjera të autorizuara.

1 Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 14/2023, 3 korrik 2023, qasur më 21 prill 2026, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=77074>

2 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rregullore Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, miratuar më 23 korrik 2024, qasur më 21 maj 2026, https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2024/08/Rregullore-Zgjedhore-Nr.-17-2024-Regjistrimi-dhe-Votimi-Jasht-Kosoves_al.pdf

ZGJEDHJET 2025: REGJISTRIMI DHE VOTIMI NGA JASHTË KOSOVËS

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti i Republikës shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, ndërsa zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit³. Në ushtrim të kësaj kompetence, më 16 gusht 2024, Presidentja Vjosa Osmani dekretoi 9 shkurtin 2025 si datë të mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta parlamentare për Kuvendin e Kosovës.

Zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 shënuan ciklin e parë të rregullt parlamentar pas një periudhe prej 18 vitesh të karakterizuar nga zgjedhje të parakohshme. Ky kontekst ndikoi drejtpërdrejt edhe në organizimin e Votimit Jashtë Kosovës, pasi kalendari i rregullt zgjedhor mundësoi një periudhë më të gjatë për planifikim institucional, informim publik dhe regjistrim të votuesve nga diaspora. Për dallim nga ciklet e mëparshme zgjedhore, ku afatet e regjistrimit zakonisht ishin të kufizuara në periudha shumë më të shkurtra, për zgjedhjet e 9 shkurtit periudha e aplikimit për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës u përcaktua në 120 ditë, nga 29 gushti deri më 26 dhjetor 2024.

Gjatë vitit 2025, pas zhvillimeve politike që çuan në shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare, Kosova hyri në një cikël të dytë zgjedhor brenda të njëjtit vit. Më 20 nëntor 2025, Presidentja Osmani caktoi 28 dhjetorin 2025 si datë për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare. Për shkak të natyrës së parakohshme të këtyre zgjedhjeve, afati për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës u kufizua ndjeshëm krahasuar me zgjedhjet e rregullta të shkurtit. KQZ hapi periudhën e aplikimit për regjistrim nga 26 nëntori deri më 6 dhjetor 2025, pra për 11 ditë.

Ndonëse zgjedhjet e shkurtit 2025 patën një periudhë më të gjatë regjistrimi dhe mundësi të reja për Votim Jashtë Kosovës, numri i aplikimeve të pranuar/dorëzuara ishte më i ulët se në vitin 2021. Në vitin 2021 ishin pranuar 130,160 aplikime/kërkesa, ndërsa në shkurt 2025 ky numër ishte 115,226.

Megjithatë, procesi i aprovimit të kërkesave shënoi përmirësim të dukshëm. Në vitin 2021 u aprovuan 102,467 aplikime, ndërsa në shkurt 2025 u aprovuan 104,942 kërkesave. Kjo nënkupton se numri i aplikimeve të refuzuara ra nga 27,693 në vitin 2021 në 10,284 në shkurt 2025.

Në zgjedhjet e jashtëzakonshme të dhjetorit 2025, numri i kërkesave për votim nga jashtë ra në 84,712, nga të cilat 77,085 u aprovuan dhe 7,627 u refuzuan. Arsyet kryesore të refuzimit të aplikimeve lidhen kryesisht me mangësi në dokumentacionin e dorëzuar dhe me pamundësinë e verifikimit të qartë të identitetit të aplikuesit. Në shumicën e rasteve, refuzimet janë si pasojë e mungesës së dokumentit të vlefshëm identifikues të Republikës së Kosovës, mospërputhjes së dokumentit me aplikuesin, mungesës së fotografisë së aplikuesit duke mbajtur dokumentin identifikues në dorë, apo dorëzimit të dokumenteve të palexueshme. Këto arsye tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e refuzimeve lidhen me probleme teknike dhe procedurale gjatë aplikimit, gjë që nënvizon rëndësinë e udhëzimeve më të qarta, informimit më të mirë dhe asistencës më të lehtë për votuesit jashtë Kosovës gjatë procesit të regjistrimit.

Rënia e kërkesave për votim nga jashtë nga shkurti në dhjetor 2025, nuk lexohet vetëm në kontekstin e afatit më të shkurtër për regjistrim. Data e zgjedhjeve në dhjetor koicidoi me pushimet e fundvitit, periudhe kjo kur shumë qytetarë që jetojnë jashtë vendit, kthehen në Kosovë. Sipas sondazhit të realizuar nga UBO Consulting për TV Du-

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 84, pika 3, dhe neni 66, paragrafi 2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, qasur më 21 prill 2026, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

kagjini, qytetarët që votuan ditën e zgjedhjeve më 28 dhjetor dhe që ishin nga diaspora përbëjnë rreth 15,5% të të anketuarve.⁴ Ndërkohë, sipas exit poll-it të Dukagjinit dhe UBO Consulting, në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, 4,5% e votuesve të anketuar në ditën e zgjedhjeve deklaruan se jetojnë në diasporë.⁵

Për të kuptuar më qartë trendin e pjesëmarrjes së votuesve jashtë Kosovës, është e rëndësishme të krahasohen jo vetëm aplikimet/kërkesat e pranuar/dorëzuara për shqyrtim, por edhe ato të aprovuara dhe të refuzuara nga KQZ-ja. Tabela në vijim paraqet zhvillimin e këtyre treguesve në ciklet zgjedhore nga viti 2010 deri në zgjedhjet e rregullta të shkurtit 2025 dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të dhjetorit 2025. Ky krahasim ndihmon në identifikimin e ndryshimeve ndër vite, si në nivelin e interesimit të diasporës për të votuar, ashtu edhe në efikasitetin e procesit të verifikimit dhe aprovimit të aplikimeve.

Viti	2010	2014	2017	2019	2021	Shkurt 2025	Dhjetor 2025
Afatet e regjistrimit ndër vite							
Afati i regjistrimit për votim jashtë vendit	n/a	7 ditë	7 ditë	12 ditë	8 ditë e 8 orë	120 ditë	11 ditë
Numri i aplikimeve të pranuar/ refuzuara/ anuluar ndër vite							
Aplikime për votim	5,015	29,745	20,354	40,313	130,168	115,226	84,712
Aplikime të aprovuara	1,640	16,569	15,118	35,087	102,467	104,942	77,085
Aplikime të refuzuara	3,375	13,176	5,236	5,226	27,693	10,284	7,627
Vota të vlefshme	n/a	10,446	9,157	24,523	55,375	77,131	62,194

Tabela 1. Afatet e regjistrimit dhe numri i aplikimeve të pranura, aprovuara, refuzuara dhe të vlefshme ndër vite

4 Portali Dukagjini, "Matjet e UBO-s, Feka: Diaspora ia sjellë tri mandate shtesë VV-së," 28 dhjetor 2025, qasur më 11 maj 2026, <https://www.dukagjini.com/matjet-e-ubo-s-feka-diaspora-ia-sjelle-tri-mandate-shtese-vv-se/>

5 Dukagjini dhe UBO Consulting, Parliamentary Elections of the Republic of Kosovo 2025: Exit Poll - Presentation of Insights, 2025, slide 14, "Do voters live in Kosovo or Diaspora?"

Numrin më të lartë të aplikimeve të aprovuara për votim nga jashtë vendit e regjistron Prishtina, e pasuar nga Prizreni, Gjilani dhe Ferizaj. Këto komuna, me popullsi më të madhe dhe një diasporë të gjerë, tregojnë një nivel të lartë të angazhimit të qytetarëve të tyre në procesin zgjedhor jashtë vendit. Në anën tjetër, komunat me numrin më të vogël të votuesve të aprovuar janë ato me shumicë serbe, ku prin Novobërda, pasuar nga Mitrovica e Veriut.

Komuna	2019	2021	Shkurt 2025	Dhjetor 2025
Prishtinë	1,367	5,524	9,089	7,553
Prizren	1,017	3,735	8,217	5,588
Gjilan	838	4,059	7,214	5,588
Ferizaj	907	3,883	6,835	5,523
Pejë	883	3,216	6,819	5,207
Gjakovë	821	2,851	6,383	4,490
Mitrovicë e Jugut	574	2,149	5,030	4,635
Suharekë	657	2,623	5,007	2,997
Podujevë	618	2,561	4,926	3,223
Vushtrri	534	2,083	4,466	3,617

Tabela 2. Shpërndarja e aplikimeve sipas komunave

Element tjetër me rëndësi është shpërndarja gjeografike jashtë vendit e votuesve të regjistruar. Të dhënat sipas shteteve tregojnë se votimi jashtë Kosovës mbetet shumë i përqendruar gjeografikisht. Në të dy proceset zgjedhore të vitit 2025, por edhe në zgjedhjet e kaluara, Gjermania dhe Zvicra përbënin afërsisht dy të tretat e të gjitha aplikimeve të aprovuara për votim jashtë vendit. Kjo konfirmon se këto dy shtete vazhdojnë të jenë qendrat kryesore të pjesëmarrjes elektorale të diasporës kosovare.

Megjithatë, krahasimi ndërmjet shkurtit dhe dhjetorit 2025 tregon edhe disa zhvendosje të rëndësishme. Ndërsa numri absolut i aplikimeve ra në shumicën e shteteve për shkak të afatit më të shkurtër dhe natyrës së zgjedhjeve të parakohshme, disa vende si SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Norvegjia shënuan rritje të lehtë në numër ose në peshë relative. Kjo sugjeron se pjesëmarrja e diasporës nuk ndikohet vetëm nga madhësia e komunitetit, por edhe nga qasja në format e votimit, informimi dhe mobilizimi politik në secilin shtet.

Tabela në vijim paraqet shpërndarjen gjeografike të pjesëmarrjes së diasporës në zgjedhjet e vitit 2021 dhe në dy proceset zgjedhore të vitit 2025. Për shkak të dallimeve metodologjike, të dhënat e vitit 2021 paraqiten vetëm si përqindje e fletëvotimeve të konfirmuara me postë sipas shteteve, ndërsa për shkurtin dhe dhjetorin 2025 paraqiten aplikimet/regjistrimet e aprovuara për votim jashtë Kosovës.

Shteti	2021	Shkurt 2025	Dhjetor 2025
Gjermani	46,8%	44,774 (42,7%)	33,463 (43,4%)
Zvicër	30,0%	27,248 (26,0%)	19,561 (25,4%)
Francë	2,7%	4,629 (4,4%)	3,584 (4,6%)
Suedi	2,7%	3,958 (3,8%)	3,773 (4,9%)
Austri	5,6%	3,932 (3,7%)	1,913 (2,5%)
Itali	2,5%	3,810 (3,6%)	1,469 (1,9%)
ShBA	1,5%	2,509 (2,4%)	2,610 (3,4%)
Belgjikë	--	2,392 (2,3%)	1,833 (2,4%)
Mbretëria e Bashkuar	1,5%	2,236 (2,1%)	2,406 (3,1%)
Finlandë	--	1,806 (1,7%)	1,086 (1,4%)
Slloveni	--	1,468 (1,4%)	620 (0,8%)
Norvegji	1,1%	1,116 (1,1%)	1,169 (1,5%)
Kanada	0,8%	1,045 (1,0%)	1,035 (1,3%)
Danimarkë	0,8%	625 (0,6%)	525 (0,7%)
Kroaci	--	490 (0,5%)	294 (0,4%)
Holandë	--	387 (0,4%)	306 (0,4%)
Turqi	--	378 (0,4%)	218 (0,3%)
Luksemburg	--	361 (0,3%)	202 (0,3%)
Mali i Zi	--	353 (0,3%)	274 (0,4%)
Serbi	0,03%	195 (0,2%)	67 (0,1%)
Shtete tjera	3,9%	1,230 (1,2%)	677 (0,9%)
Gjithsej	(100%)	104,942 (100,0%)	77,085 (100,0%)

Tabela 3. Shpërndarja gjeografike e pjesëmarrjes së diasporës

Për shkak të ndryshimit të metodologjisë ndërmjet vitit 2021⁶ dhe vitit 2025, tabela duhet të lexohet si krahasim i shpërndarjes gjeografike të pjesëmarrjes, jo si krahasim i drejtpërdrejtë i të njëjtit indikator administrativ.

6 Shënim metodologjik: Për vitin 2021, përqindjet paraqesin shpërndarjen e fletëvotimeve të konfirmuara me postë sipas shteteve, jo aplikimet e aprovuara. Për vitin 2025, të dhënat paraqesin aplikimet/regjistrimet e aprovuara për votim jashtë Kosovës, sipas shtetit dhe formës së votimit. Vendet me "--" nuk janë paraqitur veçmas në tabelën e raportit të vitit 2021 dhe përfshihen brenda kategorisë "Shtetet tjera".

ORGANIZIMI I VOTIMIT NË MISIONE DIPLOMATIKE NË ZGJEDHJET E VITIT 2025

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, votuesve jashtë Kosovës iu ofruan tri mënyra për të ushtruar të drejtën e votës: votimi fizik në përfaqësitë diplomatike, votimi përmes postës në kutitë postare të KQZ-së në Kosovë, si dhe votimi përmes kutive postare të hapura jashtë vendit me mbështetjen e ambasadave dhe konsullatave.

Për zgjedhjet e rregullta të 9 shkurtit 2025, më 29 gusht 2024, KQZ miratoi listën e qendrave të votimit jashtë Kosovës. Sipas këtij vendimi, votimi fizik ishte paraparë të organizohej në 35 ambasada dhe konsullata, me gjithsej 47 vendvotime dhe kapacitet maksimal prej 47,000 votuesish. Ky ishte një ndryshim i rëndësishëm krahasuar me ciklet e mëparshme, pasi votuesve jashtë Kosovës iu mundësua për herë të parë votimi fizik në përfaqësi diplomatike.

Megjithatë, procesi u shoqërua edhe me kufizime. Disa shtete ku jetojnë qytetarë të Kosovës, si Finlanda, Luksemburgu dhe Sllovakia, nuk u përfshinë në listën e votimit fizik. Poashtu, më 28 janar 2025, KQZ vendosi të mos organizojë votim fizik në Ankara, Kanbera dhe Iowa, për shkak të numrit të ulët të votuesve të regjistruar në këto qendra. Për këta votues, si alternativë u ofrua votimi përmes postës.

Në zgjedhjet e shkurtit 2025, për votim fizik në përfaqësi diplomatike u regjistruan gjithsej 20,324 persona. Pjesëmarrja ndryshoi ndjeshëm nga një përfaqësi në tjetrën, varësisht nga madhësia e komunitetit të diasporës dhe qasja në qendrën e votimit. Konsullata e Kosovës në Düsseldorf kishte numrin më të lartë të votuesve, ku nga 2,105 të regjistruar votuan 1,560 persona. Në anën tjetër, Ambasada e Kosovës në Shkup kishte pjesëmarrje më të ulët, me 17 votues nga 55 të regjistruar.

Në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 28 dhjetorit 2025, votimi jashtë Kosovës u organizua në kushte më të kufizuara kohore. Periudha për regjistrimin e votuesve jashtë vendit zgjati vetëm 11 ditë, nga 26 nëntori deri më 6 dhjetor 2025. Fillimisht, KQZ planifikoi një shtrirje më të gjerë të votimit fizik, me 60 qendra votimi dhe 109 vendvotime. Megjithatë, pas përfundimit të regjistrimit dhe bazuar në numrin real të votuesve që kishin zgjedhur votimin fizik, lista u rishikua. Ky proces u shoqërua edhe me kontest institucional lidhur me vendndodhjen e qendrave të votimit. Sipas raportit të Demokracisë në Veprim,⁷ KQZ fillimisht kishte vendosur që votimi të zhvillohej në 50 përfaqësi diplomatike, me 66 vendvotime në 36 shtete, ndërsa kishte paraparë edhe qendra shtesë jashtë hapësirave diplomatike mbi bazën e rekomandimeve të MPJD-së. Kjo pjesë e vendimit u anulua nga PZAP, i cili vlerësoi se votimi fizik jashtë Kosovës duhet të kufizohet në hapësirat diplomatike. Ky rast nxori në pah nevojën për qartësim ligjor dhe institucional mbi rolin e KQZ-së dhe MPJD-së në organizimin e votimit jashtë vendit.

Më 27 dhjetor 2025, votimi fizik jashtë Kosovës u zhvillua në 29 përfaqësi diplomatike, në 18 shtete, me gjithsej 40 vendvotime. Për këtë formë votimi ishin regjistruar 19,187 votues, prej të cilëve votuan 16,165, apo 84.24%.⁸ Në total, për zgjedhjet e dhjetorit 2025, lista votuese përfshinte 77,085 votues të regjistruar jashtë Kosovës, shumica e të cilëve kishin zgjedhur votimin përmes postës.

7 Demokracia në Veprim, Raporti i vëzhgimit të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, Prishtinë, 2026, në dispozicion në: www.kdi-kosova.org

8 Në të dhënat e regjistrimit, 19,260 votues kishin zgjedhur votimin fizik në përfaqësi diplomatike. Pas rishikimit operacional të qendrave ku u organizua votimi fizik, lista efektive e votuesve në përfaqësitë diplomatike përfshinte 19,187 votues, prej të cilëve votuan 16,165, apo 84.24%.


Krahasimi mes zgjedhjeve të shkurtit dhe dhjetorit 2025 tregon se modeli i ri i votimit jashtë Kosovës krijoi më shumë mundësi për pjesëmarrjen e diasporës, por zbatimi i tij mbeti i ndikuar nga afatet, kapacitetet logjistike dhe numri real i votuesve të regjistruar. Zgjedhjet e shkurtit ofruan më shumë kohë për përgatitje dhe informim, ndërsa zgjedhjet e dhjetorit e testuan të njëjtin sistem në kushte më të ngushta dhe më të shpejta organizative. Për një pasqyrë më të detajuar mbi votimin në secilën përfaqësi diplomatike, mund t'i referoheni tabelës përkatëse në vijim.

Përfaqësia Diplommatike	Shkurt 2025	Dhjetor 2025
Konsullata e Republikës së Kosovës - DÜSSELDORF	2,105	2,231
Konsullata e Republikës së Kosovës - MÜNCHEN	1,972	1,631
Konsullata e Republikës së Kosovës - STUTTGART	1,970	1,933
Konsullata e Republikës së Kosovës - CYRIH	1,953	2,114
Konsullata e Republikës së Kosovës - FRANKFURT	1,567	1,421
Ambasada e Republikës së Kosovës - LONDËR	1,020	1,219
Konsullata e Republikës së Kosovës - GJENEVË	981	1,051
Konsullata e Republikës së Kosovës - BERNË	967	1,053
Ambasada e Republikës së Kosovës - BRUKSEL	960	916
Ambasada e Republikës së Kosovës - VJENË	941	532

Tabela 4. Votimi në përfaqësitë diplomatike



ORGANIZIMI I VOTIMIT NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE GJATË ZGJEDHJEVE TË VITIT 2025 SHËNOI ZBATIMIN E PARË PRAKTIK TË REFORMËS SË RE TË VOTIMIT JASHTË KOSOVËS, DUKE ZGJERUAR MUNDËSITË E PJESËMARRJES SË DIASPORËS PËRMES VOTIMIT FIZIK DHE ALTERNATIVE POSTARE, POR NJËKOHËSISHT DUKE EVIDENTUAR SFIDA LIGJORE, LOGJISTIKE DHE ORGANIZATIVE NË ADMINISTRIMIN E PROCESIT.



PJESËMARRJA DHE MËNYRAT E VOTIMIT NË VITIN 2025

Krahasimi mes zgjedhjeve të 9 shkurtit dhe 28 dhjetorit 2025 tregon dy dinamika të ndryshme të Votimit Jashtë Kosovës. Në zgjedhjet e rregullta të shkurtit, numri i kërkesave, aplikimeve të aprovuara dhe votave të pranuar nga jashtë ishte më i lartë, çka lidhet me afatin më të gjatë të regjistrimit dhe kohën më të madhe për informim e organizim. Në dhjetor, për shkak të natyrës së parakohshme të zgjedhjeve, datës kur u mbajtën ato dhe afateve më të ngushta, numri total i aplikimeve dhe votave ishte më i ulët.

Treguesi	Shkurt 2025	Dhjetor 2025
Kërkesa për votim jashtë Kosovës	115,226	84,712
Aplikime/kërkesa të aprovuara	104,942	77,085
Të refuzuara/anuluara	10,284	7,627
Shkalla e aprovimit	91.1%	91.0%

Tabela 5 Numri i kërkesave dhe aplikimeve të aprovuara

Megjithatë, dhjetori tregoi disa përmirësime në efikasitetin administrativ të procesit. Shkalla e aprovimit të kërkesave mbeti pothuajse e njëjtë me shkurtin, rreth 91%, ndërsa votat e vlefshme si përqindje e votave të konsideruara për numërim u rritën nga 97.6% në 99.1%. Po ashtu, norma e pavlefshmërisë ra nga 2.39% në 0.9%, ndërsa numri i zarfeve postare të refuzuara u ul nga 4,898 në 2,364.

Në aspektin e mënyrës së votimit, votimi përmes postës mbeti forma dominuese në të dy proceset. Megjithatë, në dhjetor u vërejt një rritje relative e peshës së votimit fizik në përfaqësi diplomatike dhe e përdorimit të kutive postare jashtë Kosovës, ndërsa përdorimi i kutisë postare në Kosovë ra ndjeshëm. Kjo sugjeron se modeli shumë-kanalësh i votimit jashtë Kosovës filloi të konsolidohet, por mbetet shumë i ndikuar nga afatet, informimi, periudha e mbajtjes së zgjedhjeve dhe qasja praktike e votuesve në secilin kanal votimi.

Mënyra e zgjedhur e votimit	Shkurt 2025	% e të aprovuarve	Dhjetor 2025	% e të aprovuarve
Kuti postare jashtë Kosovës	67,496	64.3%	55,099	71.5%
Kuti postare në Kosovë	17,104	16.3%	2,726	3.5%
Votim fizik në përfaqësi diplomatike	20,342	19.4%	19,260	25.0%
Gjithsej të aprovuar	104,942	100%	77,085	100%

Tabela 6. Mënyra e zgjedhur e votimit

EFIKASITETI I PROCESIT

Krahasimi ndërmjet zgjedhjeve të 9 shkurtit dhe 28 dhjetorit 2025 tregon se, pavarësisht rënies së numrit të përgjithshëm të aplikimeve dhe votave nga jashtë Kosovës në zgjedhjet e dhjetorit, procesi shënoi përmirësim në aspektin e efikasitetit administrativ. Në të dy proceset, shkalla e aprovimit të kërkesave për votim jashtë Kosovës mbeti pothuajse e njëjtë, rreth 91%, çka tregon një nivel relativisht të qëndrueshëm të verifikimit të aplikimeve.

Megjithatë, dallimi më i rëndësishëm vërehet në fazën pas regjistrimit. Në shkurt 2025, nga 104,942 aplikime të aprovuara, 79,019 votues ushtruan të drejtën e votës, dhe votat e tyre u numëruan, që përbën rreth 75.3% të të aprovuarve. Në dhjetor 2025, nga 77,085 aplikime të aprovuara, 62,730 votues ushtruan të drejtën e tyre dhe votat e tyre u numëruan, apo rreth 81.4% e të aprovuarve. Kjo tregon se, ndonëse pjesëmarrja absolute ishte më e ulët në dhjetor, përqindja e votuesve të aprovuar që arritën të votojnë dhe të hyjnë në procesin e numërimit ishte më e lartë.

Po ashtu, cilësia procedurale e votave të pranuar për numërim u përmirësua. Në shkurt, 77,131 vota u pranuan të vlefshme dhe 2.39% u shpallën të pavlefshme, ndërsa në dhjetor 62,194 vota u pranuan të vlefshme dhe vetëm 0.9% u shpallën të pavlefshme. Edhe numri i zarfeve postare të refuzuara dhe të paprocesuara ra nga 4,898 në shkurt në 2,364 në dhjetor. Këto të dhëna sugjerojnë se, në ciklin e dytë zgjedhor të vitit 2025, votuesit dhe administrata zgjedhore kishin një nivel më të lartë familjarizimi me procedurat e reja, ndërsa gabimet teknike dhe pavlefshmëria u reduktuan ndjeshëm.

Treguesi	Shkurt 2025	Dhjetor 2025
Pjesëmarrja nga totali i votuesve të regjistruar	75.3%	81.4%
Vota të vlefshme si % e votuesve të regjistruar	73.5%	80.7%
Vota të vlefshme si % e votave të numëruara	97.6%	99.1%
Norma e pavlefshmërisë së votave të numëruara	2.39%	0.9%
Zarfe postare të refuzuara për arsye teknike si % e votuesve që zgjedhën postën	5.8%	4.1%

Tabela 7. Pjesëmarrja nga totali i votuesve të regjistruar dhe vlefshmëria e votave

Në këtë kuptim, zgjedhjet e dhjetorit 2025 dëshmojnë një paradoks të rëndësishëm: procesi kishte më pak pjesëmarrje në numra absolutë, por ishte më efikas në raport me votuesit e aprovuar dhe me vlefshmërinë e votave të pranuar. Kjo tregon se sistemi i ri shumë-kanalësh i Votimit Jashtë Kosovës filloi të prodhojë më shumë qëndrueshmëri procedurale, por mbetet i varur nga afatet, informimi publik dhe kapaciteti operacional i institucioneve për ta zbatuar atë në mënyrë të barabartë në çdo cikël zgjedhor.

NDIKIMI ELEKTORAL I VOTËS SË DIASPORËS

Në krahasim me zgjedhjet e vitit 2021, Lëvizja Vetëvendosje ruajti pozitën si subjekti më i votuar nga diaspora. Në shkurt 2025, LVV mori pothuajse të njëjtin numër votash si në vitin 2021, me një rënie shumë të vogël nga 44,252 në 44,224 vota. Ndërkohë, LDK shënoi rritjen më të madhe, duke kaluar nga 4,294 vota në vitin 2021 në 20,042 vota në shkurt 2025. Edhe PDK shënoi rritje, nga 5,032 në 7,053 vota. AAK dhe Nisma, të cilat në vitin 2021 garuan ndaras, ndërsa në shkurt 2025 si koalicion, së bashku kaluan nga 1,553 vota në 2,299 vota.




Tabela 8. Votat e vlefshme nga jashtë si % e votave totale të vlefshme

Ky raund i zgjedhjeve poashtu tregoi një dinamikë tjetër sa i përket shpërndarjes së votës për parti politike. LVV jo vetëm që ruajti pozitën dominuese, por e rriti mbështetjen nga diaspora në 47,455 vota. Në anën tjetër, LDK dhe PDK shënuan rënie të dukshme krahasuar me shkurtin 2025: LDK ra nga 20,042 në 5,373 vota, ndërsa PDK nga 7,053 në 5,232 vota. AAK dhe Nisma, të cilat në dhjetor garuan ndaras, së bashku morën 2,241 vota, nivel shumë i afërt me rezultatin që kishin arritur si koalicion në shkurt.

Në përgjithësi, krahasimi mes vitit 2021, shkurtit 2025 dhe dhjetorit 2025 tregon se vota e diasporës mbeti e përqendruar kryesisht te LVV, ndërsa mbështetja për subjektet e tjera ndryshoi ndjeshëm varësisht nga cikli zgjedhor, forma e garimit dhe konteksti politik.

Për të kuptuar më qartë mënyrën se si diaspora e ushtroi të drejtën e votës, është e rëndësishme të dallohen votat e dërguara përmes postës nga ato të hedhura fizikisht në përfaqësitë diplomatike. Në vitin 2021, votimi jashtë Kosovës u realizua vetëm përmes postës, prandaj nuk ka të dhëna për votim në përfaqësi diplomatike. Ndërsa në dy ciklet zgjedhore të vitit 2025, votuesit jashtë Kosovës patën mundësi të zgjedhin mes votimit me postë dhe votimit fizik në ambasada apo konsullata.

Të dhënat tregojnë se, edhe pas hapjes së mundësisë për votim fizik, votimi me postë mbeti forma kryesore e pjesëmarrjes. Në shkurt 2025, pjesa më e madhe e votave për secilin subjekt kryesor erdhi përmes postës. Për LVV-në, nga 44,224 vota gjithsej, 31,963 ishin me postë dhe 12,261 në përfaqësi diplomatike. Edhe te LDK dhe PDK, votat me postë ishin dukshëm më të larta se ato në përfaqësi diplomatike.




Tabela 9. Rezultatet e përgjithshme të votimit jashtë Kosovës sipas subjekteve politike, 2021-2025

Në dhjetor 2025, kjo prirje vazhdoi, por me disa ndryshime të rëndësishme. LVV pati rritje si në votat me postë, ashtu edhe në ato në përfaqësi diplomatike, duke marrë 33,556 vota me postë dhe 13,899 në përfaqësi diplomatike. Ndërkohë, LDK dhe PDK shënuan rënie në të dyja format e votimit krahasuar me shkurtin. AAK dhe Nisma, që në shkurt ishin pjesë e koalicionit AAK/Nisma, në dhjetor garuan ndaras; së bashku, ato ruajtën pothuajse të njëjtin nivel mbështetjeje, por me AAK-në që mori pjesën më të madhe të votave.

Kjo ndarje tregon se votimi fizik në përfaqësi diplomatike krijoi një kanal të ri dhe të rëndësishëm pjesëmarrjeje për diasporën, por nuk e zëvendësoi votimin me postë. Përkundrazi, votimi me postë mbeti forma dominuese, ndërsa përfaqësitë diplomatike shërbyen si mundësi shtesë, sidomos në vendet ku komunitetet e diasporës janë më të përqendruara dhe kanë qasje më të lehtë në ambasada apo konsullata.

Partitë Politike	2021		Shkurt 2025		Dhjetor 2025	
	Me postë	Përfaqësi Diplommatike	Me postë	Përfaqësi Diplommatike	Me postë	Përfaqësi Diplommatike
LVV	44,252	n/a	31,963	12,261	33,556	13,899
PDK	5,032	n/a	5,878	1,175	4,259	973
LDK	4,294	n/a	18,933	1,109	4,611	762
AAK/NISMA	n/a	n/a	2,000	299	n/a	n/a
AAK	1,112	n/a	n/a	n/a	1,801	255
NISMA	441	n/a	n/a	n/a	149	36

Tabela 10. Rezultatet e votimit jashtë Kosovës sipas formës së votimit: me postë dhe në përfaqësi diplomatike, 2021-2025

TOP 20 KANDIDATËT MË TË VOTUAR

Të dhënat për 20 kandidatët më të votuar tregojnë se vota e diasporës në vitin 2025 mbeti kryesisht e përqendruar te kandidatët e Lëvizja Vetëvendosje. Në të dy ciklet zgjedhore, Albin Kurti dhe Glauk Konjufca kryesuan me numrin më të madh të votave nga jashtë vendit, duke shënuar edhe rritje në zgjedhjet e dhjetorit 2025. Rritje të dukshme patën edhe kandidatët si Albulena Haxhiu, Hekuran Murati, Donika Gërvalla-Schwarz dhe Ejup Maqedonci, duke treguar konsolidim të mbështetjes së diasporës për një pjesë të kandidatëve të LVV-së.

Në anën tjetër, kandidatët e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) shënuan rënie të ndryshme të votave nga diaspora, përfshirë Lumir Abdixhiku, Doarsa Kica-Xhelili dhe Kujtim Shala. Rënie u evidentua edhe te disa kandidatë të partive tjera, megjithëse në nivele të ndryshme.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se vota e diasporës pati ndikim të rëndësishëm në fuqinë elektorale të kandidatëve individualë, duke treguar përqendrim të lartë të votës së diasporës te kandidatët e LVV-së në të dy proceset zgjedhore dhe duke reflektuar ndryshime të dukshme në mbështetjen politike mes zgjedhjeve të shkurtit dhe dhjetorit 2025.

Emri dhe Mbiemri i Kandidatit	Zgjedhjet Shkurt 2021 Vota Totale	Vota nga Diaspora (% krahasuar me votat totale)	Zgjedhjet Shkurt 2025 Vota Totale*	Vota nga Diaspora (% krahasuar me votat totale)	Zgjedhjet Dhjetor 2025 Vota Totale	Vota nga Diaspora (% krahasuar me votat totale)
Albin Kurti	n/a*	n/a	337,791	41,300 (12.23%)	403,521	44,095 (10.93%)
Glauk Konjufca	200,646	31,029 (15.46%)	264,407	36,329 (13.74%)	318,459	39,192 (12.31%)
Lumir Abdixhiku	25,267	910 (3.60%)	146,401	18,319 (12.51%)	88,207	4,101 (4.65%)
Faton Peci	25,284	2,548 (10.08%)	133,987	22,860 (17.06%)	n/a	n/a
Hekuran Murati	41,172	6,342 (15.40%)	131,323	22,983 (17.50%)	171,622	24,517 (14.29%)
Albulena Haxhiu	n/a	n/a	125,722	21,814 (17.35%)	174,456	26,993 (15.47%)
Xhelal Sveçla	10,359	1,493 (14.41%)	122,407	23,096 (18.87%)	138,423	21,140 (15.27%)
Donika Gërvalla-Schwarz	71,722	15,234 (21.24%)	113,239	20,335 (17.96%)	153,271	22,401 (14.61%)
Bedri Hamza	23,976	1,537 (6.41%)	98,415	6,429 (6.53%)	161,737	4,696 (2.90%)
Avni Dehari	51,126	6,401 (12.52%)	91,538	12,004 (13.10%)	108,083	11,463 (10.61%)
Mimoza Kusari Lila	53,618	10,906 (20.34%)	85,737	14,088 (16.43%)	99,390	13,172 (13.25%)
Arben Vitia	107,858	16,664 (15.45%)	71,074	13,329 (18.76%)	67,541	10,114 (14.98%)
Ejup Maqedonci	n/a	n/a	65,056	10,843 (16.67%)	98,093	15,177 (15.47%)
Doarsa Kica Xhelili*	10,609	737 (6.95%)	63,164	10,565 (16.73%)	44,170	2,624 (5.94%)
Kujtim Shala	32,703	2,083 (6.37%)	58,817	12,490 (21.24%)	40,983	2,600 (6.34%)
Saranda Bogujevci	26,389	3,769 (14.28%)	48,299	8,170 (16.91%)	51,268	7,407 (14.45%)
Edona Llaloshi	n/a	n/a	44,844	7,987 (17.81%)	44,395	8,238 (18.56%)
Mefail Bajqinovci	18,794	1,681 (8.94%)	42,340	7,420 (17.52%)	41,585	6,390 (15.36%)
Armend Muja	43,982	9,910 (22.53%)	34,455	9,331 (27.08%)	38,538	8,567 (22.23%)
Hysen Çekaj	n/a	n/a	23,539	12,098 (51.40%)	n/a	n/a

*Top 20shtja më e votuar në Diasporë është bazuar në Zgjedhjet e Rregullta - Shkurt 2025

*n/a referohet te kandidatët që nuk kanë qenë pjesë e Listës për Deputet në Zgjedhjet Shkurt 2021 dhe Dhjetor 2025

*Doarsa Kica Xhelili, në zgjedhjet Shkurt 2021, ka qenë pjesë e Listës së Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa në dy palë zgjedhjet e vitit 2025, pjesë e Listës së Lidhjes Demokratike të Kosovës

*Ngjyra më e hapur tregon përqindje më të ulët të votës nga diaspora, ndërsa duke u mbyllur tregon rritje të përqindjes.

Tabela 11, Top 20 kandidatët më të votuar në diasporë

SFIDAT KRYESORE NË ORGANIZIM, QASJE DHE TRANSPARENÇË

Procesi i votimit në diasporë në zgjedhjet e vitit 2025 u vlerësua përgjithësisht si i rregullt dhe pa shkelje madhore që do të cenonin integritetin e rezultateve. Megjithatë, gjatë fazave të ndryshme të procesit – nga regjistrimi i votuesve, përcaktimi i qendrave të votimit, votimi fizik dhe me postë, deri te numërimi i votave – u evidentuan disa paqartësi procedurale dhe mungesë informimi me kohë, të cilat krijuan shqetësime te votuesit jashtë Kosovës dhe organizatat që e monitoruan procesin.

Përcaktimi i qendrave të votimit në përfaqësi diplomatike: Një nga çështjet kryesore lidhej me listën e qendrave të votimit ishte numri i vendvotimeve dhe kapaciteti maksimal i votuesve. Vendimi i KQZ-së u prit me pakënaqësi nga një pjesë e diasporës, sidomos në shtetet ku nuk u mundësua votimi fizik. Germin kërkoi sqarime nga KQZ dhe MPJD lidhur me kriteret e përzgjedhjes. KQZ sqaroi se vlerësimi bëhet në bashkëpunim me MPJD-në dhe në bazë të kriterëve teknike, ndërsa MPJD nuk ofroi përgjigje ndaj kërkesës për informata publike. Kjo ngriti shqetësime për transparencën institucionale në një proces që prek drejtpërdrejt të drejtën e votës së qytetarëve nga diaspora.

Paqartësitë rreth kutive postare jashtë Kosovës: Në zgjedhjet e 9 Shkurtit shqetësime pati edhe për mënyrën e përzgjedhjes dhe administrimit të kutive postare të KQZ-së jashtë vendit. Në Gjermani, organizata të diasporës ngritën shqetësime pasi adresa e publikuar për dërgimin e fletëvotimeve nuk ishte objekt diplomatik apo zyrë postare shtetërore, por një filial privat postar. KQZ sqaroi se kutitë postare ishin hapur me asistencën e MPJD-së dhe se legjislacioni nuk përcakton kriteret specifike për llojin e postës apo kutisë postare. Megjithatë, ky rast tregoi nevojën për komunikim më të qartë publik mbi sigurinë dhe administrimin e adresave postare.

Kontestet politike dhe juridike rreth integritetit të votimit me postë: Pas numërimit të votave me postë në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, u ngritën pretendime publike për manipulim të votave me postë në favor të LDK-së, të lidhura kryesisht me dallimet e mëdha ndërmjet votave të disa kandidatëve në votimin me postë dhe atyre në përfaqësi diplomatike. LVV parashtroi ankesë në PZAP, duke kërkuar anulimin e 18,933 votave me postë të LDK-së, përsëritjen e votimit me postë dhe largimin nga lista të disa kandidatëve të këtij subjekti. PZAP e refuzoi ankesën si të pabazuar, ndërsa Gjykata Supreme e refuzoi më pas si të pathemeltë ankesën kundër vendimit të PZAP-it. Edhe pse këto pretendime nuk u vërtetuan nga organet kompetente zgjedhore dhe gjyqësore, rasti nxori në pah rëndësinë e auditimit më të detajuar të votimit me postë, sidomos në nivel kandidatësh, shtetesh dhe kanalesh të votimit. Dallimet e mëdha ndërmjet votimit me postë dhe votimit fizik nuk duhet të trajtohen automatikisht si dëshmi manipulimi, por ato duhet të jenë subjekt i analizës institucionale paszgjedhore, në mënyrë që të forcohet besimi publik në integritetin e procesit.

Akreditimi i vëzhguesve në diasporë: Edhe pse KQZ për herë të parë mundësoi aplikimin elektronik për vëzhgues, udhëzimet në portal nuk ishin të përditësuara dhe platforma nuk ofronte mundësi të qartë për të dalluar nëse vëzhguesi do të angazhohej brenda apo jashtë Kosovës⁹. Po ashtu, shpërndarja e bexhave u bë shumë afër ditës së zgjedhjeve, duke krijuar vështirësi praktike për organizatat që kishin vëzhgues në përfaqësitë diplomatike. Në

9 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Akreditimi i vëzhguesve të OJQ-ve," qasur më 11 maj 2026, <https://kqz-ks.org/sher-bime-per-ojq-dhe-medie/akreditimi-i-vezhguesve-te-ojq-ve/>

të ardhmen, platforma duhet të përfshijë kategori të veçantë për vëzhguesit në diasporë, ndërsa bexhat duhet të lëshohen më herët ose të zëvendësohen me forma elektronike verifikimi.

Transporti dhe tërheqja e materialeve zgjedhore: Për shkak të vonesave në procedurat tenderuese për shërbimet postare, KQZ u detyrua të përdorë zgjidhje alternative për transportimin e materialeve zgjedhore, me përfshirjen e zyrtarëve të saj dhe ndihmën e MPJD-së. Edhe pse kjo u bë për të garantuar vazhdimësinë dhe sigurinë e procesit, ndryshimi i procedurës nuk u komunikua mjaftueshëm në kohë, duke krijuar pasiguri te publiku. Për këtë çështje, në zgjedhjet e 9 shkurtit KQZ doli me sqarim për publikun¹⁰. Në zgjedhjet e ardhshme, sidomos në rastet e zgjedhjeve të rregullta, planifikimi i shërbimeve logjistike duhet të përfundojë më herët apo edhe të bëhen kontrata më afatgjata për shërbime deri në katër vite të vlefshme.

Udhëzimet jo të unifikuara për komisionerët: Gjatë vëzhgimit të votimit fizik në disa përfaqësi diplomatike, Germin vërejt se udhëzimet për komisionerët nuk ishin gjithmonë të njëtrajtshme. Në raste të caktuara kishte interpretime të ndryshme lidhur me votimin me dokumente të skaduar, mundësinë e votimit me postë pas regjistrimit për votim fizik, si dhe raportimin e shiritave të sigurisë. Kjo tregon nevojën për udhëzime më të standardizuara dhe trajnime më të qarta për komisionerët dhe kryesuesit e qendrave të votimit jashtë Kosovës.

Vonesat në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve: Procesi në dy palë zgjedhjet në QNR në u karakterizua nga vonesa të konsiderueshme, pasi vlerësimi dhe numërimi i votave nga diaspora zgjati shumë. Gjatë monitorimit u vërejt se trajnimi i stafit dhe procesi i numërimit zhvilloheshin paralelisht, gjë që tregoi mungesë përgatitjeje të mjaftueshme. Megjithatë, një aspekt pozitiv ishte vendosja e kamerave monitoruese në tavolinat e punës në QNR, e cila rriti transparencën dhe lehtësoi vëzhgimin e procesit.

Kontestet për afatet e pranimit të votave me postë: Në zgjedhjet e dhjetorit 2025 pati ankesa lidhur me pranimin e disa fletëvotimeve me postë pas datës 29 dhjetor. Këto ankesa u refuzuan nga PZAP dhe Gjykata Supreme kryesisht për arsye procedurale dhe për shkak të moskontestimit në kohë të vendimeve përkatëse. Rasti tregon se votimi me postë kërkon komunikim më të qartë publik për afatet, vendimet administrative dhe mjetet e ankesës, në mënyrë që subjektet politike dhe votuesit të kenë siguri juridike mbi trajtimin e fletëvotimeve nga jashtë Kosovës.

Në përgjithësi, këto raste nuk e cenuan integritetin e zgjedhjeve, por treguan se organizimi i votimit jashtë Kosovës kërkon më shumë transparencë, komunikim më të hershëm me publikun, standardizim të procedurave dhe planifikim më të mirë logjistik. Këto përmirësime janë të domosdoshme për të rritur besimin e votuesve nga diaspora dhe për të garantuar pjesëmarrje të barabartë në ciklet e ardhshme zgjedhore.

¹⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Sqarim lidhur me dërgimin dhe tërheqjen e materialeve zgjedhore nga votimi jashtë Kosovës," 3 shkurt 2025, qasur më 21 maj 2025, <https://kqz-ks.org/sqarim-lidhur-me-dergimin-dhe-terheqjen-e-materialeve-zgjedhore-nga-votimi-jashte-kosoves/>

REKOMANDIMET

1. Qartësimi i vendndodhjes së qendrave të votimit jashtë Kosovës

Ligji duhet të përcaktojë qartë nëse votimi fizik mund të organizohet vetëm në përfaqësi diplomatike apo edhe në hapësira të tjera të autorizuara. Pa këtë qartësi, çdo proces i ardhshëm mund të prodhojë konteste të ngjashme. Në rast vendoset të konsiderohet mundësia e përdorimit të hapësirave alternative, ky proces duhet të zhvillohet duke marrë në konsideratë kërkesat/nevojat e bashkatdhetarëve. Gjithashtu, duhet konsideruar implikimet operationale në shtetet pritëse.

2. Ndarja e qartë e përgjegjësiave ndërmjet KQZ-së dhe MPJD-së

KQZ dhe MPJD duhet të kenë ndarje më të qartë të përgjegjësiave në organizimin e Votimit Jashtë Kosovës. KQZ duhet të mbajë autoritetin e plotë mbi aspektet zgjedhore, administrative dhe operationale të procesit, përfshirë procedurat, listat e votuesve, organizimin e vendvotimeve, udhëzimet për komisionerët, akreditimin e vëzhguesve dhe administrimin e materialeve zgjedhore. Bashkëpunimi KQZ-MPJD duhet të rregullohet përmes një protokollit të qartë operational, që përcakton rolet, afatet, përgjegjësitë dhe zinxhirin e komunikimit për çdo fazë të Votimit Jashtë Kosovës.

3. Zbatimi transparent dhe rishikimi i kuotës për votimin fizik në diasporë

Me përditësim të Rregullores për Regjistrim dhe Votim Jashtë vendit, më datë 27.04.2026 (Nr. 01/2026), KQZ ka përcaktuar pragun minimal prej 50 votuesish të regjistruar suksesshëm si kusht për organizimin e votimit fizik në një qendër votimi jashtë Kosovës. Ky është një hap pozitiv drejt qartësimi të kriterëve për hapjen e qendrave të votimit në përfaqësi diplomatike. Megjithatë, zbatimi i kësaj kuote duhet të jetë transparent dhe i komunikueshëm me kohë. Në të ardhmen, pragu prej 50 votuesish duhet të vlerësohet periodikisht në raport me shpërndarjen gjeografike të diasporës, kapacitetet e përfaqësive diplomatike dhe qasjen e votuesve në qendra votimi. Comment end .

4. Përmirësimi i informimit publik për votuesit jashtë Kosovës

KQZ, në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe organizatat e diasporës, duhet të zhvillojë fushata më të qarta dhe më të hershme informuese për votuesit në diasporë. Informimi duhet të përfshijë afatet e regjistrimit, mënyrat e votimit, dokumentet e nevojshme, kriteret për aplikim dhe arsyet më të shpeshta të refuzimit. Kjo do të ndihmonte në uljen e gabimeve teknike gjatë aplikimit dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në proces.

5. Krijimi i njësisë së përhershme për Votimin Jashtë Kosovës brenda KQZ-së

KQZ duhet të krijojë një njësi të përhershme për Votimin Jashtë Kosovës, e cila do të merrej në mënyrë të vazhdueshme me planifikimin, koordinimin me përfaqësitë diplomatike, informimin e votuesve, standardizimin e procedurave dhe analizën paszgjedhore. Një nga detyrat kryesore të kësaj njësie duhet

të jetë përgatitja e një raporti të veçantë pas çdo procesi zgjedhor, ku përfshihen aplikimet, refuzimet, mënyrat e votimit, kutitë postare, transporti, zarfet e refuzuara, votat e pavlefshme dhe ankesat.

6. Standardizimi i procedurave dhe forcimi i planifikimit operacional

KQZ duhet të standardizojë udhëzimet për komisionerët, vëzhguesit dhe stafin e përfshirë në votimin jashtë Kosovës, në mënyrë që rregullat të zbatohen njëtrajtshëm në të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Kjo përfshin udhëzime të qarta për dokumentet e votuesve, procedurat e votimit, raportimin e materialeve të sigurisë, akreditimin e vëzhguesve dhe menaxhimin e procesit në QNR.

Në të njëjtën kohë, KQZ duhet të shmangë varësinë nga prokurimet e reja për çdo palë zgjedhje, sidomos për transportin dhe tërheqjen e materialeve zgjedhore nga diaspora. Duke marrë parasysh se në Kosovë zgjedhjet shpesh mbahen më herët se cikli i rregullt katërvjeçar, KQZ duhet të shqyrtojë lidhjen e marrëveshjeve kornizë shumëvjeçare me operatorë ndërkombëtarë të besueshëm të logjistikës, si p.sh. DHL apo operatorë të ngjashëm. Një marrëveshje 4-vjeçare do të mundësonte reagim më të shpejtë, siguri më të madhe në transport dhe shmanjie të improvizimeve në rast të zgjedhjeve të parakohshme.

Poashtu, siguria në QNR duhet të forcohet, veçanërisht në raport me qasjen e vëzhguesve, kontaktin me stafin që fut të dhënat në sistem dhe mbrojtjen e personelit nga presioni i mundshëm gjatë procesit të numërimit.

Këto rekomandime synojnë të përmirësojnë qasjen, transparencën dhe besueshmërinë e votimit jashtë Kosovës. Përvoja e zgjedhjeve të vitit 2025 tregon se, përveç ndryshimeve ligjore, procesi kërkon planifikim më të hershëm, komunikim më të qartë me diasporën dhe procedura më të qëndrueshme institucionale, veçanërisht në raste të zgjedhjeve të parakohshme.



REKOMANDIMET E RAPORTIT SYNOJNË FORCIMIN E QARTËSISË LIGJORE, TRANSPARENCËS INSTITUCIONALE DHE KAPACITETEVE ORGANIZATIVE TË VOTIMIT JASHTË KOSOVËS PËRMES STANDARDIZIMIT TË PROCEDURAVE, PËRMIRËSIMIT TË INFORMIMIT PUBLIK, PLANIFIKIMIT MË EFIKAS OPERACIONAL DHE KRIJIMIT TË MEKANIZMAVE TË PËRHERSHËM PËR ADMINISTRIMIN DHE AUDITIMIN E VOTIMIT TË DIASPORËS.

PËRFUNDIME

Procesi i Votimit Jashtë Kosovës në dy ciklet zgjedhore të vitit 2025 tregoi se diaspora vazhdon të ketë interes të lartë për pjesëmarrje në zgjedhje, por se ky interes ndikohet drejtpërdrejt nga afatet, informimi publik dhe lehtësia e procedurave. Në zgjedhjet e rregullta të shkurtit 2025, pavarësisht rënies së numrit të aplikimeve të pranuar krahasuar me vitin 2021, numri i aplikimeve të aprovuara u rrit lehtë, duke treguar përmirësim në procesin e verifikimit. Në zgjedhjet e jashtëzakonshme të dhjetorit 2025, ndërkaq, numri i aplikimeve dhe votuesve të regjistruar jashtë Kosovës ishte më i ulët, çka duhet lexuar në kontekstin e afateve shumë më të shkurtra dhe natyrës së parakohshme të zgjedhjeve.

Ndryshimet ligjore që mundësuan votimin fizik në përfaqësitë diplomatike dhe hapjen e kutive postare jashtë Kosovës përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të qasjes së diasporës në procesin zgjedhor. Megjithatë, përvoja e vitit 2025 tregoi se mundësitë e reja ligjore nuk mjaftojnë pa planifikim të hershëm, informim të qartë dhe kapacitete të qëndrueshme organizative. Kufizimi i numrit të qendrave të votimit, mospërfshirja e disa shteteve, paqartësitë rreth kutive postare dhe udhëzimet jo gjithmonë të unifikuara krijuan vështirësi për një pjesë të qytetarëve nga diaspora.

Një nga sfidat kryesore mbeti informimi i pamjaftueshëm i votuesve. Një pjesë e refuzimeve të aplikimeve lidhej me dokumentacion të paplotë, mungesë të fotografisë së kërkuar, dokumente të palexueshme apo mospërputhje të të dhënave. Kjo tregon se shumë probleme nuk kishin të bënin domosdoshmërisht me mungesën e të drejtës për votim, por me paqartësi procedurale dhe mungesë udhëzimesh të thjeshta e të kuptueshme për votuesit.

Edhe vëzhgimet e organizatave vendore konfirmojnë se, ndonëse Votimi Jashtë Kosovës mbeti segment teknikisht i ndjeshëm, administrimi i tij nuk prodhoi kontestime madhore që do të cenonin rezultatin. Kjo e bën të rëndësishme që kritika ndaj procesit të fokusohet te përmirësimi sistematik – qartësia ligjore, planifikimi, informimi dhe standardizimi – e jo te delegjitimimi i rezultatit.

Në përgjithësi, votimi jashtë Kosovës në vitin 2025 u zhvillua pa parregullsi madhore që do të cenonin kredibilitetin e rezultateve. Megjithatë, dy proceset zgjedhore dëshmuar se organizimi i votimit nga diaspora kërkon më shumë transparencë, standardizim të procedurave dhe planifikim më të mirë institucional. Përmirësimet në informim, logjistikë, akreditim të vëzhguesve, transport të materialeve dhe funksionim të qendrave të votimit janë të domosdoshme për të garantuar një proces më të qasshëm, më të besueshëm dhe më gjithëpërfshirës për qytetarët e Kosovës në diasporë.

GERMIN është organizatë joqeveritare e përkushtuar për fuqizimin dhe lidhjen e diasporës shqiptare në mbarë botën. Duke shfrytëzuar inovacionin, teknologjinë dhe rrjetet globale, GERMIN punon për të forcuar rolin e diasporës në zhvillimin social, ekonomik dhe demokratik të vendeve të origjinës. Duke vepruar si një urë lidhëse midis komuniteteve të diasporës dhe institucioneve vendore, organizata nxit bashkëpunimin, promovon shkëmbimin e njohurive dhe mbështet iniciativa që sjellin zhvillim të qëndrueshëm dhe ndikim afatgjatë.

Avokim dhe Diplomaci

Ky program fokusohet në fuqizimin e diasporës përmes avokimit dhe përfshirjes në politika. GERMIN forcon lidhjet mes diasporës dhe institucioneve vendore, duke promovuar pjesëmarrjen e saj në proceset vendimmarrëse. Iniciativat kryesore përfshijnë projekte të zhvillimit të politikave, Konferencën Diaspora Flet, fellowship-e rajonale për të rinjtë, si dhe monitorimin e zgjedhjeve për të garantuar të drejtat e votimit dhe përfaqësimin e diasporës.

Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora

GERMIN mundëson transferimin e njohurive dhe ekspertizës nga profesionistët e diasporës drejt vendeve të tyre të origjinës. Përmes platformave të rrjetëzimit, mentorimit dhe angazhimeve afatshkurtra, programi lidh profesionistët me institucione dhe organizata në Kosovë. Ai përfshin partneritete dhe projekte që mbështesin gratë në politikë, sipërmarrjen dhe zhvillimin e kapaciteteve në sektorë të ndryshëm, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin socio-ekonomik.

Filantropia e Diasporës

Ky program promovon dhurimin e strukturuar dhe me ndikim nga diaspora. Në bashkëpunim me Global Albanians Foundation, GERMIN mundëson mbledhje fondesh transparente dhe efikase për organizatat jofitimprurëse. Ai ndihmon në orientimin e kontributeve të diasporës drejt projekteve të zhvillimit social dhe ekonomik, duke reduktuar pengesat për donacionet ndërkufitare.

Të Rinjtë dhe Edukimi

GERMIN punon për të lidhur arsimin me nevojat e tregut të punës duke angazhuar të rinj nga Kosova dhe diaspora. OriginAL është programi kryesor që ofron për të rinjtë e diasporës shqiptare një përvojë gjithëpërfshirëse edukative, kulturore dhe vullnetare në vendet e origjinës, duke i ndihmuar të rikthejnë lidhjen me rrënjët e tyre dhe të ndërtojnë marrëdhënie afatgjata.

Investimet e Diasporës

Ky program synon të shndërrojë remitencat e diasporës në investime strategjike që nxisin rritjen ekonomike afatgjatë. GERMIN mbështet promovimin e investimeve, rrjetëzimin e bizneseve dhe partneritetet publiko-private. Përmes forumeve, iniciativave komunale dhe projekteve të synuara, ai lidh investitorët e diasporës me mundësitë lokale, duke nxitur krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.